



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice*

Duke u bazuar në Rregulloren Nr. 2001/19 (Dega Ekzekutive e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë), Rregulloren Nr. 2001/36 Mbi Shërbimin Civil të Kosovës, Urdhëresën Administrative Nr. 2003/2, Udhëzimin Administrativ Nr. MSHP/DASHC 2003/1 mbi procedurën e rekrutimit, Ministria e Drejtësisë shpallë këtë:

**K O N K U R S**

**III: PROKURORIA E SHETITIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**5. Pozita: Zyrtar për mardhënie me publikun (Zëdhënës) - 1 (një vende pune) - rishpallje**

**Referenca: MD/PSHRK/18 - 08 - 05 - 2010**

**Paga: 286 € Koeficienti: 8**

**I përgjigjet: Administratorit**

**Vendi: Prishtinë**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Drejton Raportet e përditshme me publikun ,
- Koordinon aktivitet e prokurorisë që kanë të bëjnë; me publikun dhe informimin e brendshëm.
- Në konsultim me Administratorin dhe prokurorin e shtetit punon në kërkesat e publikun dhe në kërkesat zyrtare për informim lidhur me punën e prokurorisë së Shtetit,
- Punon si zëdhënës i Prokurorisë së shtetit . Udhëheqë dhe organizon kontaktet me media me qëllim të përgatitjes së konferencave, takimeve dhe vizitave zyrtare
- Përpilon informata për media, komunikata për media, dhe dokumeta tjera të botuara në shtypë e që kanë të bëjnë me Prokurorin e Shtetit,
- Mirëmban Faqen e internetit të prokurorisë së Shtetit.
- Kryen edhe punë tjera profesionale me kërkesën e Administratorit të Prokurorisë.

**Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:**

- Përgatitja e lart profesionale (fakulteti)e dëshirueshme nga lëmi e gazetarisë ose komunikimit masiv apo të ngjashme;
- Të jetë banor i Republikës së Kosovës.
- Tri (3) vjet përvojë pune e dëshirueshme në profesion;
- Të ketë aftësi të shkëlqyeshme analitike dhe organizative, aftësi për komunikim ( me gojë dhe me shkrim), aftësi për planifikim, aftësi për të identifikuar prioritetet,
- Të njoh shumë mirë të ( flasë dhe të shkruaj ) gjuhen Shqipe, Serbe, dhe Angleze,
- Të jetë i gatshëm të punoj me informata të besueshme ,
- Të njoh shumë mirë punën me Kompjuter ( MSWord, Excel, Explorer)
- Të mos jetë nën hetime apo të jetë iniciuar procedura penale ndaj tij/ saj.

**Periudha e kontratës:**

Punësimi bëhet me kontratë, kontrata e punës lidhet për periudhë kohore prej 1 viti, me 3 muaj punë provuese dhe me mundësi të vazhdimit të kontratës.

**Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:** Ministria e Drejtësisë / Divizioni i Burimeve Njerëzore, Rruga « Ish-Ndërtesa e Rilindjes» kati i 7 - të, Zyra Nr. 723, Prishtinë, Kosovë;

**Për informata të hollësishme mund të kontaktoni zyrën e Divizionit të Burimeve Njerëzore në, tel: 038 / 213 860 ose 038 - 200 182 86), prej orës 08:00 - 16:00.**

**Konkursi ngel i hapur 15 ditë** nga dita e publikimit në njërin nga gazetat ditore, duke filluar nga data **18.08.2010** gjer më datën **01.09.2010** që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrin brenda 4 ditësh, aplikacionet që arrin pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë.

Kandidatët të cilën hynë në përzgjedhje të ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga personeli.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë përmes telefonit dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para komisionit intervistues.